

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. 1037/24
Nr. i fq. / Br. st.
Data: / Datum 28.06.2024
VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

**Procesverbali nga takimi i parë publik me qytetarë i Kryetarit të Komunës
për punën gjashtë mujore Janar-Qershori 2024**

Qershori 2024

Takimi i parë publik me qytetarë i kryetarit të Komunës

Datë: 28.06.2024

Ora: 11:00

Vendi: Qendra e Kulturës “Hasan Prishtina”

Takimi është hapur nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, i cili para qytetarëve të pranishëm ka prezantuar raportin për punën gjashtë mujore (Janar-Qershori 2024) të ekzekutivit.

Të pranishëm kanë qenë edhe të gjithë drejtorët e drejtorive.

Ferit Idrizi, kryetar i Komunës së Vushtrrisë, falënderoi qytetarët pjesëmarrës në takim.

Fillimisht para juve do të paraqes një përbledhje të punëve që janë bërë nga janari deri në muaji qershori 2024, e më pas do të keni edhe ju mundësinë që të bëni pyetje.

Në fushën e arsimit, kemi rritur numrin e bursave në 87 për studentët vushtrias, që studiojnë në universitetet publike dhe private të Kosovës, rajonit dhe atyre të BE-së, kemi rritur shumën e mjeteve, në 600€ për studentët që studiojnë në Kosovë, në 800€ për studentët që studiojnë në vendet e rajonit, ndërsa në 1000€, për ata/ato që studiojnë në vendet e BE-së.

Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me University Of York, Europe Campus, për ndarjen e 10 bursave studimi për vitin akademik 2024/2025.

Subvencionimi 100% i të rinjve që përfundojnë me sukses aftësimin profesional në Diakonie Training Center, profilet janë instalues i ngrohjes qendrore, instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, instalues elektrik, qeramikë, knauf, fasadë dhe ngjyrosje, grim, rrobaqepësi dhe parukeri. Vitin e kaluar 2023, kemi subvencionuar 37 të rinj në shumën prej 9,100.00 euro që kanë përfunduar me sukses aftësimin profesional në Diakonie Training Center.

Po ashtu, subvencionojmë deri në 100 euro ata që ndjekin kurset për gjuhë gjermane apo frëngje në SPEEX Education. Vitin e kaluar 2023, kemi subvencionuar 1219 të rinj në shumën prej 127,060.00 euro që kanë ndjekur trajnimet në SPEEX Education dhe qendra tjera.

Kemi organizuar garat e diturisë për nxënësit e klasave të pesta dhe të nënta, me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim. Për organizimin e garave të diturisë është përdorur platforma digitale.

Ka filluar ndërtimi i shkollës “Mustafë Venhari”, që do të jetë një shkollë model.

Për realizimin e mësimit dual, kemi arritur marrëveshje me Loni Decor që nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike “Lutfi Musiqi” të ndjekin praktikën profesionale.

Kemi mbështetur me bileta të udhëtimit nxënëset e Gjimnazit “Eqrem Çabej” për pjesëmarrje në një hulumtim shkencor në SHBA.

Gjithashtu, jemi komuna e parë që e kemi përmbyllur pjesën e kontratës kolektive.

Në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, kemi pastruar të gjitha përrockat dhe kemi bërë zgjerimin dhe pastrimin e shtretërve të lumenjve. Është bërë pastrimi dhe zgjerimi i shtratit të lumit në Pantinë, në fshatin Ceceli, në fshatin Samadrexhë, në Studime të Epërme, në fshatin Sllatinë, në fshatin Pestovë, rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Smrekonicë, ku është bërë pastrimi, zgjerimi, betonimi dhe murosja e shtratit të lumit, në fshatin Bukosh, në fshatin Novolan.

Sa i përket drejtorive, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, tregu i gjelbër me parking nëntokësor është duke u punuar dhe prodhuesit vendor do të kenë një vend adekuat për të ekspozuar produktet e tyre.

Sheshi i qytetit është duke u rikonstruar dhe po ndërtohet parkingu nëntokësor, është projekt i më sfidues por që me përfundimin e punimeve ky shesh do ta transformoj qytetin tonë.

Kemi rregulluar Kompleksin e masakrës së 2 Majit, në fshatin Studime të Epërme.

Është bërë rregullimi i shëtitores “Enver Zymberi”, me ulëse, shporta për mbeturina, ndriçim, si dhe i shëtitores në lumin Podranqa”, e pajisur me ndriçim modern dhe shteg për ecje e biçikleta.

Për parkun rekreativ “Udha e Gurit” janë ndarë 329,418.84 euro, që do të ketë shëtitore, hapësirë gjelbëruese, kënd të lojërave, dy fusha të tenisit, një fushë multifunksionale.

Është bërë ndërtimi i urave në fshatrat Akrashticë, Duboc, Smrekonicë dhe Studime e Epërme.

Gjithashtu, kemi bërë rregullimin e rrugëve të rendit të katërt në fshatin Pasomë

Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për realizimin e disa projekteve, siç janë Projekti i rrugës R220 nga Ura e Silnicës deri tek Llamkos; Projekti i rehabilitimit të rrugëve në fshatrat Akrashticë-Balincë; Projekti i rehabilitimit të rrugës nga magjistralja N2 Dumnica e Ulët-Dumnica e Epërme; Projekti i rehabilitimit të rrugës “Dëshmorët e Kombit.

Do të bëjmë obeliskun e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Brenda afatit rekord, ka përfunduar rregullimi i trotuarit nga rruga kryesore e fshatit Samadrexhë deri tek varri i heroit Afrim Bunjaku.

Gjatë këtij gjashtë mujori, kemi punuar edhe në shtrirjen e rrjetit të kanalizimit, Nedakoc-kolektori kryesor, Studime-kolektori kryesor, Reznik-shtrirja e rrjetit të kanalizimit, Beçuk-shtrirja e rrjetit të kanalizimit, Zhilivodë-shtrirja e rrjetit të kanalizimi, Stroc- shtrirja e rrjetit të kanalizimit, Mihaliq-shtrirja e rrjetit të kanalizimit.

Sa i përket ofrimit të shërbimeve në Administratën e Komunës së Vushtrrisë, nuk kemi asnjë ankesë nga ana e qytetarëve, kemi ofruar pa pagesë të gjitha llojet e certifikatave për përdorim brenda Republikës së Kosovës, si dhe kemi ofruar shërbime të veçanta për diasporën, ku zyrtarët e Gjendjes Civile kanë punuar edhe ditën e shtunë.

Në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, kemi bërë renovimin e tërësishëm të Qendrës së Mjekësisë Familjare-1, si dhe është bërë zgjatja e orarit për ofrimin e shërbimeve të rëntgenit.

Në Drejtorinë për Bujqësi, kemi bërë subvencionimin e 103 fermerëve (blegtorëve) me 5 cent për litër qumësh, gjithashtu kemi nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me IADK për realizimin e projektit “Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjve që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktivitetave bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit”. Do të ndahen grante të vogla në sektorin e përpunimit të frutave, perimeve,ëmbëlsirave apo produkteve të qumështit.

Po ashtu, kemi nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me Ibër Lepenc, për subvencionimin me 50% të shpenzimeve për ujitjen e tokave bujqësore.

Më pas fjala ka kaluar tek qytetarët, të cilët kanë paraqitur kërkesat e tyre.

Skender Osmani, nga fshati Mihaliq, e keni sjell kanalizimin mbi ujë të pijes dhe kam qenë në Komunë më kanë thënë që deri aty e kemi pas projektin.

Feim Imeri, nga fshati Dumnicë, e kemi kërkesën për ujë në lagjen Zenaj, i kemi edhe disa kërkesa të tjera. Problemi që po e kemi në lagjen Zenaj tek varrezat e dëshmorëve në rrugë kemi kërkuar disa herë pengesa se po ka aksidente, një trotuar me e qitë kish qenë mirë. Ndricimi i varrezave të dëshmorëve, kish qenë mirë me i ndërru dritat sepse janë dobësuar. Unë jam bujk i punoj rreth 14 hektar tokë, sherri i rrugëve që na janë bllokuar nga kanalizimi unë duhet me dal në një fshat tjetër me i punu diku rreth 10 hektar tokë i kam atje, kish qenë mirë me ba hapjen e rrugëve. Kanalizimi që bërë asnjë kapak i shaktave nuk e kanë qitë, po jemi të rezikuar.

Shemsedin Zenuni, nga fshati Mihaliq, e keni shtruar rrugën me asfalt na e keni pru rrugën deri tek dyert e shtëpisë, mirëpo një kojshi nuk ka lejuar të largohet një masë e dheut dhe nuk po mundemi me u afro tek shtëpia prej saj. Kërkoi që të largohet dheu.

Behgjet Mehollı, nga fshati Akrashticë, për kontributin tuaj faleminderit, por drejtorët e drejtorive po i sabotojnë punët, shumë punë tek ne i kanë lanë në gjysmë, asfaltin e kanë lënë që tre vite copa-copa, ura e vjetër ka mbetur aty nuk është hequr. Sa i përket mbeturinave, duhet me ju ble automjete punëtorëve.

Ajete Tahiri, nga fshati Novolan, që katër vite jemi si shoqatë në Komunën e Vushtrrisë, ne kemi qenë në shkollën “Mustafë Venhari” kemi punuar në bufenë e shkollës, nga pandemia na ndryshuan që komuna ju jepte ushqim nxënësve dhe ne nuk kishim llogari të punojmë në bufe dhe u dashtë me mylli, po me mendimin si të kryhet kiflet që ishin nga qeveria ne të vazhdojmë punën tonë. Që 4 vite kemi mbetur pa punë 4 veta. Kam bërë ankesë dhe nuk është marrë parasysh, mjetet e punës na janë marrë. Na kanë lënë pa punë dhe i kanë marrë mjetet i kanë dërgu diku tjetër.

Blerim Ibrahimı, nga shoqëria civile, duke ju falënderuar së pari për punën dhe angazhimin tuaj që jeni duke e bërë në infrastrukturën rrugore, në shqyrtimin dhe aprovin e kërkesave të qytetarëve. Kërkesa ime është, tek varrezat e vjetra të qytetit të rishikohet një rrrethojë apo një dizajn nga venet e tjera që rregullojë atë pjesë duke pasur parasysh që është bërë edhe investim në infrastrukturë, ka mbetur vetëm çështja e varrezave dhe të rregullohet ajo pjesë. Kërkesa ime e dytë është që Këshillat Lokal për Siguri Publike, që janë duke e luajtur një rol të rëndësishëm sa i përket sigurisë, të ndahet një buxhet për realizimin e projekteve në çështje të sigurisë.

Fikrije Ferizi, nga OJQ ATO, këtë vit nuk më është ndarë buxhet nga drejtoria e Shëndetësisë, punoj për sëmundjet e kancerit të gjirit, mbaj ligjérata vetëdijësuese. Edhe pse kam aplikuar nuk më është ndarë buxhet. Kështu që, e kam kërkesë që të përkrahem. E kam edhe një kërkesë sa i përket objektit ku ne veprojmë, janë edhe Shoqatat e dala nga lufta, objektit është mjerim, si të hysh në derë kundërmon. Edhe një shqetësim si gjithmonë, janë qentë endacak. Një kërkesë tjetër e kam te varrezat e qytetit kish qenë mirë të merret një iniciativë që të pastrohen.

Hamdi Shyti, kryetar i Këshillit Lokal në Oshlan, ju përgëzoj për punën kryetar, në emër të komunitetit që unë prezantoj ju falënderoj për disa rrugë e disa rrugica që janë ndërtuar në lokalitetin tonë. Fshati Oshlan nuk ka tabelë njoftuese fare, nuk ka Gurbardhi fare. Një cështje tjetër që është akute e qytetarëve të këtij lokaliteti është çështja e ndriçimit, shihet sikur me qenë një diskriminim i këtij fshati i cili nuk ka ndriçim. Çështja e kanalizimit është çështje që po e presim që do të bëhet në të ardhmen, megjithatë sa i përket infrastrukturës rrugore është deri diku e mirë, është rruga që lidh fshatin me fabrikën e ujit, vërtetë është nevojë jashtëzakonisht për qytetarët, kishte me qenë mirë që në buxhetin e ardhshme të jetë. Një sugjerim e kam për drejtoritë komunale, ne si kryetar të këshillit lokal që jemi mungon bashkëpunimi.

Ismajl Bekteshi, banor nga fshati Dumnicë e Poshtme, reka apo përroi që e kanë qelë e kanë qitë nëpër pronë time, 80% shkon nëpër pronën time e 20% tek një tjetër, kam bërë ankesë.

Bashkim Selmani, nga fshati Ropicë, për ujë të pijes ku është gjendja.

Rasim Lahu, banor i fshatit Skoqan, kërkesë në emër të fshatit Skoqan, për rrugën Begaj-Skoqan, janë ndërtuar tri shtëpi të reja, janë hapë tri ferma të deleve dhe të dhive, një fermë e buallicave, është në ndërtim e sipër një fermë e pulave, kështu që, kërkesa ime është që të rregullohet rruga.

Halil Bejta, banor nga Vushtria, në lidhje me zgjerimin e një kioske që e keni bërë tek parku dhe që dy vite nuk marrë përgjigje, zgjerimi i kioskës po ma pengon derën e lokalit.

Hasime Gérxhaliu, banore e fshatit Studime, rruga “2 maji” është e shtruar deri në gjysmë, 30 km nuk e kanë shtuar rrugën. Kisha pas dëshirë të vini dhe ta shihni cka është pyetja që nuk është shtruar. Tek zjarrfikësit po qitet bërrloku po vjen era shumë kérkoj që të vendoset një kontejner.

Muhamed Mustafa, banor i fshatit Smrekonicë, në emër të fshatit të falënderoj se fshati Smrekonicë sot ka ujë. E kam një kërkesë, bërrloku na shkakton problem po vijnë edhe nga fshatrat tjera po na e qesin para shtëpisë, të na largohet. Po dëshiroj të ju them bashkëqytetarëve këtu, se unë jetoj në perëndim, mirépo këta që jetojnë këtu rregullisht nuk e shohin çfarë ndryshimesh dhe çfarë përparimi ka bërë Komuna e Vushtrrisë kohët e fundit, më të vërtetë është shumë mbresëlënëse. Unë e pash një peizazh tek Silnica, aty me tu kënaq zemra çfarë rregullimi është bërë. Unë në fshatin tim brenda 2 vitesh kam parë ndryshim shumë të madh. Për 2025 ndoshta rrugën mundesh me e rregullu.

Sabile Gjaka, banore e fshatit Oshlan, për vitin 2025 a ka ndonjë subvencion për gratë që jetojnë në zona rurale.

Xhelil Haziri, banor i fshatit Druar, kam ardhur me një kërkesë rruga “Ushtari i UÇK”, që nga pas lufta asnjë bager zhavor nuk është vendosur. Komplet lagija jemi të bllokuar ju lutem ndërmerrni diçka.

Avdi Mulaku, banor në lagjen Ahmet Selaci, kërkesa e parë rruga “Ahmet Selaci” që të vendoset një pengesë rrugore, ku kanë ndodhë disa aksidente. Kërkesa e dytë, mbrapa xhamisë Karamanli është një trëndafil e ka marrë gjysën e rrugës, të shortohet se po është problem rruga.

Fehmi Shala, banor i fshatit Stanoc i Epërm, i kam dy kërkesa, nevojë urgjente është rregullimi i kanalizimit të lagjeve Maloku, Prronaj, Haradinah, Bregaj dhe i disa shtëpive të tjera. Kërkesa e dytë, furnizimi me ujë të pijes për disa shtëpi pjesë e dy lagjeve, sepse lagje komplet pa ujë nuk ka, konkretisht disa shtëpi ne lagjet Bllacaj, Bregaj dhe Ajvazi, disa shtëpi. Për fshatin Gracë edhe kanalizimin edhe ujin me e rregullu.

Faik Hasani, banor i fshatit Sfaraqak, dëshiroj të ju pyes cka është puna e ujit në Sfaraqak dhe kanalizimit që është nisur që sa, edhe për cka me ju dhënë fshatit celësi i pompës e me u mylli me dry pompa.

Hamëz Makiqi, banor i fshatit Reznik, i kam tri kërkesa, e para asfaltimi i rrugës buzë kanalit tek lagja Makiqi dhe Rrustemi, largimi i deponisë në lagjen Mustafa dhe Halili, e treta kërkoj ndërtimin e një terreni sportiv në lagjen Halili afér shkollës.

Hasan Hyseni, banor i fshatit Sfaraqak, 95 përqind rrugët e fshatit janë të shtruar, rruga tek unë diku 215m është e vetmja që është e pashtuar. Nëse ka mundësi me e dërgu zhavor, kishit bë mirë.

Ferki Beqiri, banor i fshatit Sfaraqak, një rrugë bë fshatin Sfaraqak, është asfalt dhe ka nevojë për ndërhyrje nëse ka mundësi.

Takimi ka përfunduar në ora 12:30.

Procesmbajtëse:

Mirjeta Duraku

Mirjeta Duraku

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë

Ferit Idrizi





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRISË

Lista e pjesëmarrësve

Takimi i parë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Datë: 28.06.2024

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Blerim Ibrahimini	B. Ibra	Vushtri
2	Hamez Makizi	H. Makizi	Reznič
3	Hesnije Meni	H. Meni	Vushtri
4	Lerme Javalli	L. Javalli	Morina
5	Fetije Gjefi	F. Gjefi	Lumadhi
6	Dhurata Reçhmani	D. Reçhmani	Lamorec
7	S. Heklije Muçagi	S. Muçagi	Begaj
8	Bukuriç Muçiqi	B. Muçiqi	Vishfani
9	Fatime Melenica	F. M. Melenica	Vushtri
10	Myrto Sholla	M. Sholla	Pekrohtic
11	Fatmire Zejri	F. Zejri	Vushtri
12	Mojme Mani	M. Mani	OSHLAN
13	Ganimet Bushimi	G. Bushimi	OSIAN
14	Vildane Halaku	V. Halaku	Vushtri
15	AFLIT ZYNGERI	A. ZYNGERI	VILSATLLI
16	Hasime Gjethollija	H. Gjethollija	STUDIME



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRISË

Lista e pjesëmarrësve

Takimi i parë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Datë: 28.06.2024

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
17	Hani i de Salloshi		HSallashi
18	Bedrije Moshani Blashki		Moshani Magjistri
19	Nençivane Kremi		Zhilivodë
20	Nefire Munos NM		Moshunoy
21	Shkurti Zekolla		Moshunoy
22	Fitneta Krashiqi		Zhilivod
23	Hava Popova	Popova	Studime
24	Albulena Gërmaliu	Aej	Studime e poshtme
25	Nozife Menxhiqi N. Merga		Sporagobisult
26	SABILE GJAKA	OSHIAN	Gjaku
27	Mihane Mehmeti	Mehmeti	OSHIAN
28	SHKENDIJE BRAHIMI		OSHIAN
29	Zyrafete Krasiqi		Zhilivo
30	Besat moshani.		Vushtri
31	RINOR BEQIRI		VUSHTRRI
32	Izai Teka		Vushtri



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRISË

Lista e pjesëmarrësve

Takimi i parë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Datë: 28.06.2024

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
33	Gjon Boçuci		SATNAORESH
34	Zemel Begim		
35	Ferdi Begimi		VUSHTRRI
35	Ismaele Gërgjoxhi		VUSHTRRI
37	ARBEN - PARDUZI		VESEKOF
38	Rasim Lahi		SKOCANI DITËSH
39	Msimat Haxhi		VUSHTRRI
40	Besmir Ahmeti		VUSHTRRI
41	Dritë Siboni		Vushtrri
42	Feim IMERI		FSH. ZEVNAJ
43	Behxhet Mehulli		AKRASAT
44	Veqil i pucë		hiqep
45	Hysni Ullët Hoxha		VUSHTRRI
46	Aktete Devani		Vushtrri
47	Azemine Lashica		Vushtrri
48	Sabahata Jashari		Vushtrri



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRISË

Lista e pjesëmarrësve

Takimi i parë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Datë: 28.06.2024

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
49	Akif Regjim Omeri	AKIF REGJIM OMERI	KOMUNA E VUSHTRRISË
50	Husnafin Shkurti	HUSNAFIN SHKURTI	KOMUNA E VUSHTRRISË
51	Avi Haji	AVI HAJI	KOMUNA E VUSHTRRISË
52	Isat Hysni	ISAT HYSNI	KOMUNA E VUSHTRRISË
53	Ramiz Pashali	RAMIZ PASHALI	KOMUNA E VUSHTRRISË
54	Ermeli Bajrami	ERMELI BAJRAMI	KOMUNA E VUSHTRRISË
55	Gehim Shala	GEHIM SHALA	KOMUNA E VUSHTRRISË
56	SADREDIN HASBEKUCCI	SADREDIN HASBEKUCCI	KOMUNA E VUSHTRRISË
57	Zenë Handimiq	ZENË HANDIMIQ	KOMUNA E VUSHTRRISË
58	FIKRIZJE FERIZI	FIKRIZJE FERIZI	KOMUNA E VUSHTRRISË
59	AJETE TAHIRI	AJETE TAHIRI	KOMUNA E VUSHTRRISË
60	Murat Mehmeti	MURAT MEHMETI	KOMUNA E VUSHTRRISË
61	Gezim Saraci	GEZIM SARACI	KOMUNA E VUSHTRRISË
62	Adem Zoma	ADEM ZOMA	KOMUNA E VUSHTRRISË
63	Hysav Stevci	HYSAV STEVCI	KOMUNA E VUSHTRRISË
64	Borrell Osmos	BORELL OSMOS	KOMUNA E VUSHTRRISË
	Razim Azem	RAZIM AZEM	KOMUNA E VUSHTRRISË



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRISË

Lista e pjesëmarrësve

Takimi i parë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Datë: 28.06.2024

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
65	Hamdi Shyti	Gjessjtë	Osmani
66	Ahmed Jashari	Ahmed	
67	Hasan Kryezi	Qiri	
68	Halil Beke	Bek	Vushtrri
69	BASHIRI - SLEMANI	Abdul	Rofec
70	Zelmi Hoxha	Zelmi	Vushtrri
71	Medina Bungaku	Medina	Vushtrri
72	Ismail Jashari	Ismail	Vushtrri
73	RAFET LAHU	Rafet	Vushtrri
74	ERGJIM SUNDUR	Ergjim	VUSHTRRI
75	IZET MIRZOVI	Izet	Vushtrri
76	Benjamin Shala	Benjamin	Vushtrri
77	Jelale Hyseni	Jelale	Vushtrri
78	FAKETE OSMANI	Fakete	Vushtrri
79	SADETE Mehmeti	Sadete	Vushtrri
80			